

INSTITUCIONALIZOHEN RAPORTET MES POLICISË SE SHQIPËRISË DHE UNMIK-UT NE KOSOVE

Nga Xhavit Shala

Intervistë për gazetën kosovare “Koha Ditore”¹

Gazeta “Koha Ditore”: Zoti Kolonel, keni mbi 6 muaj qe jeni ne krye te delegacionit te nivelit te larte te palës Shqiptare ne takimet me policinë e UNMIK-ut ne Kosove. Ne cfare niveli janë këto marrëdhënie si dhe efektet konkrete te këtyre takimeve ?

Xhavit Shala: Marrëdhëniet midis policisë Shqiptare dhe strukturave homologe te UNMIK-ut tashme janë institucionalizuar, bëhen takime te përmuajshme një here ne Tirane dhe një here ne Prishtine. Vlen te theksohet se nga takimi ne takim është rritur besimi dhe mirëkuptimi “reciprok”. Ky bashkëpunim ka dhënë frytet e veta-siç është rasti i ekstradimit nga Kosova për ne Shqipëri te shtetasit Shqiptar Bujar Germizi, i plagosur ne tentative për te vjedhur paratë e Bankës se Kursimeve ne Kukës dhe i kapur nga forcat e KFOR-it ne Kosove. Fryt i bashkëpunimit është dhe institucionalizimi i takimeve dypalëshe. Megjithatë mbetet akoma për te bere.

Gazeta “Koha Ditore”: Kontrabanda dhe trafiket e paligjshme janë prezent ne hapësirën e kufirit tokësor dhe detar ne Shqipëri, përfshire këtu dhe kufirin Kosove – Shqipëri ku aktualisht behet kontrabande mallrash si dhe trafik makinash te vjedhura madje dhe armesh. Çfarë masash kane marre policitë e dy vendeve për te luftuar ketë trafik dhe si është bashkëpunuar ne ketë drejtim ?

Xhavit Shala: Është e vërtete se ka pasur kalim mallrash kontrabande ne këto pika qe po i quajmë te palicencuara (te pa miratuara).Duhet theksuar diçka qe historikisht zona e Tropojës dhe e Hasit tregtinë e kane zhvilluar ne Gjakove e Prizren. Kjo tregti u ndërpre gjate regjimit komunist. Edhe sot ne këto zona është me e lehte rruga e tregtisë ne këto dy qytete, sesa ne Tirane. Por infrastruktura për te përfunduar atë është e papërgatitur, gati inekzistente. Nuk ka pika doganore te rregullta. Nga pala shqiptare është kërkuar qe ne Qafe Morine e Qafe Prushi te bëhen vendkalime kufitare te rregullta. Për pasoje do te kishte një shërbim te kontrolluar mallrash e do te pritej rruga kontrabandës. Por,brezi kufitar këtu ruhet ende nga KFOR-i për pjesën e Kosovës. Me tu marre ne administrim nga UNMIK-u krijohen te gjitha kushtet për hapjen e vendkalimeve kufitare te rregullta. Kjo gjë do te

¹ Intervista është botuar ne gazetën kosovare “Koha Ditore”, me date 05.11.2000

ndikonte dukshëm ne përmirësimin e kushteve sociale ne zonat e Tropojës dhe Hasit. Megjithatë, policia Shqiptare ka bere një pune te madhe për te ndaluar kontrabandën dhe trafiqet e paligjshme ne ketë zone. Ditët e fundit janë bere operacione te suksesshme policore për arrestimin e individëve dhe grupeve qe merren me vjedhjen e makinave, kontrabande dh grabitje,ne zonat e Qafe – Morinës ne Tropojë. Po kështu është vepruar edhe ne zonën e Hasit, ku janë arrestuar edhe zyrtare policie te implikuar ne këto trafiqe si ish shefi i Komisariatit te Policisë Has, ish shefi i policisë kriminale te këtij Komisariati, komandanti i postes se kufirit Dobrunë etj.

Gazeta “Koha Ditore”: Çfarë hapash janë marre nga delegacioni shqiptar i Ministrisë se Rendit Publik te Shqipërisë për nënshkrimin e një marrëveshje ekstradimi kur dihet qe shume kriminele nga Shqipëria strehohen ne Kosove e anasjelltas ?

Xhavit Shala: Ndjehet domosdoshmëria e një marrëveshje te tille ekstradimi, por tani për tani ky problem nuk mund te zgjidhet sepse është ne vartësi te statusit te Kosovës. Por, megjithatë ndonëse nuk ka një marrëveshje te tille, de facto ekstradimet janë realizuar.

Gazeta “Koha Ditore”: Ne takimet dypalëshe është diskutuar problemi i trafikut te kurdëve e prostitutave kur Kosova tashme është një linje e këtij trafikut ?

Xhavit Shala: Dua te theksoj se linjat ndërkombëtare te trafikut klandestin orientohen ne ato drejtime ku nuk hasin pengesa gjete rrugës. Grupet e arrestuara kohet e fundit ne Shqipëri kane evidentuar Kosovën si një drejtim i ri i këtij trafikut. Dhe qe ne shume motele e hotele ne Kosove e Maqedoni ”shërbejnë” shume moldave, te cilat synojnë te gjejnë momentin për te kaluar ne Perëndim. Ky problem është cekur edhe ne takimin e fundit me policinë e UNMIK-ut ne Prishtine. Ne te ardhmen mbetet një nga drejtimet kryesore ne thellimin e bashkëpunimit.

Gazeta “Koha Ditore”: Ne takimet ndërkufitare ne nivel rajonal,policia vendore e këtyre rajoneve ne Shqipëri ka kërkuar qe këto takime te institucionalizohen. A ndihet i nevojshëm nënshkrimi i një marrëveshje ?

Xhavit Shala: Mendoj se takimet ne nivel rajonal janë te institucionalizuar tashme dhe bëhen takime sipas kërkesave te secilës pale. Dua te theksoj se e rëndësishme është se çfarë arrihet dhe jo marrëveshjet.

Gazeta “Koha Ditore”: Ne analizën gjashtëmuajore te këtij viti te zhvilluar ne Ministrinë e Rendit Publik,Ministri Spartak Poçi e ka cilësuar vrasjen e vëllezërve kosovare nga Peja Ibrahim e Rexhep Nikçi, si ngjarja me e rende dhe e ka shpallur prioritet te punës se policisë zbulimin dhe kapjen e autoreve. Çfarë është arritur ne ketë drejtim ?

Xhavit Shala: Është e vërtetë se Ministri Poçi ka caktuar detyra për zbulimin e autoreve të vrasjes së vëllezërve Nikçi nga Peja. Policia kriminale e ka realizuar këtë detyrë. Shume shpejt do të njiheni me këtë fakt, njëherazi do të marrin fund edhe spekulimet e ndryshme lidhur me këtë vrasje.

Gazeta “Koha Ditore”: Ku qëndron angazhimi i policisë Shqiptare për të neutralizuar grabitjet e karvanëve me Kosovare që udhëtojnë në segmentin e rrugës Durrës – Morinë ?

Xhavit Shala: Dua të theksoj me përgjegjësi që nga policia Shqiptare tashme jepen garanci maksimale për karvanët e kosovareve që lëvizin nga Durrësi në Kosovë. Nga Ministri Poçi janë nxjerre urdhra të veçante dhe janë angazhuar forca policore për shoqërimin e tyre nga Durrësi në Morinë. Raste grabitje kane ndodhur atëherë kur kane lëvizur të shkëputur dhe në orë të vona. Nga policia Shqiptare janë goditur në vazhdimësi personat që kane bërë grabitje në këtë aks rrugor. Reagimi i policisë ka qenë i ashpër deri në asgjësimin fizik të këtyre grabitësve. Por duhet të theksoj që behet shpesh në propagandë e qëllimshme për gjoja pasiguri në këtë aks rrugor dhe kjo me synim që kosovaret që vijnë nga perëndimi të shmangin Shqipërinë nga itinerari i tyre për në Kosovë.

Gazeta “Koha Ditore”: Ka disa muaj që është paralajmëruar një vizite e Ministrit të Rendit Publik të Shqipërisë Spartak Poçi në Prishtinë. Kur do të realizohet kjo ?

Xhavit Shala: Po, është diskutuar një vizite e Ministrit Poçi në Kosovë dhe ajo do të realizohet shumë shpejt, pasi janë marrë hapa konkrete për këtë .

Gazeta “Koha Ditore”: A janë të motivuara dhe të vendosura strukturat policore të UNMIK-ut për të vendosur rendin dhe për të luftuar krimin në Kosovë ?

Xhavit Shala: Mendoj se kjo pyetje nuk më takon mua, por duhet theksuar se shifrat e kriminalitetit në Kosovë kanë pësuar rënie. Dhe kjo fale punës së këtyre strukturave dhe shkallës së lartë të qytetarisë së kosovareve.

Gazeta “Koha Ditore”: Çfarë masash ka marrë Ministria e Rendit Publik ndaj personave me uniforme, me sakte policeve që u vënë “gjoba” Kosovareve ?

Xhavit Shala: Thuhet se kosovaret kur kalojnë në segmentin rrugor paguajnë nën dorë “gjoba” neper postbllloqe policore. Nuk e mohoj përderisa janë arrestuar police që kanë abuzuar në këtë drejtim, por s’do më vinte mirë që ky të quhej fenomen. Unë do të bëj thirrje bashkatdhetarëve të mi që nëse konstatojnë raste abuzimi, të bëjnë denoncim në stacionin më të afërm të policisë.

Gazeta “Koha Ditore”: Ne kanalin televiziv RAI UNO presidenti i sapo zgjedhur i Serbisë Vojisllav Koshtunica mes te tjerash ka deklaruar”Ai qe ju quani tension ne Beograd është ne shuarje e sipër dhe tani konflikti do te marre përmasa te tjera ne Kosove, Mal te Zi dhe Shqipëri. Veçanërisht ne Shqipëri ku kontradiktat mes veriut dhe jugut janë ashpërsuar shume,madje kane filluar te provokojnë qe tani destabilizim ne zonat e veriut te Shqipërisë. Duke përmendur veriun e Shqipërisë Koshtunica ka pasur parasysh zhvillimet e fundit rreth këtyre ngjarjeve ?

Xhavit Shala: Unë do te flas për anën “policore” te këtyre ngjarjeve. Personat e inkriminuar dhe te përzier ne trafikë janë përpjekur t'i kundërvihen me arme policisë. Reagimi i policisë ka qene i ashpër duke arrestuar dhjetëra prej tyre. Dihet se gjate kohës se krizës ne Kosove, ne Tropojë ka pasur probleme me rendin dhe sigurinë. Kjo pasi këto probleme ishin marre përsipër te zgjidhen nga klane te caktuara. Përfundimisht shteti Shqiptar nuk do te lejoje qe ne Tropojë te behet politike klanesh ku njeri klan te zëvendësoje tjetrin. Atje do te veproje vetëm ligji.

